

VENDIM
Nr.861, datë 21.11.2007

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË
TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12 dhe 13 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Transportit, mbi bazën e reformimit të Institutit të Studimeve të Transportit, si person juridik publik shtetëror, buxhetor, me seli në Tiranë dhe në varësi të ministrisë, që mbulon çështjet e transportit.

2. Instituti i Transportit ka si objekt të veprimtarisë:

a) Të krijojë një database për sektorin e transportit, për secilin lloj të tij, me të dhëna, që do të përdoren bashkërisht, për të gjitha veprimtaritë e sektorit të transportit, si dhe ta mirëmbajë e përditësojë këtë database.

b) Të funksionojë si një burim qendror i informacionit për sektorin e transportit dhe t’i sigurojë ministrisë, që mbulon çështjet e transportit, të dhëna dhe instrumente analitike, për zhvillimin e politikave e të strategjisë për këtë sektor.

c) Të përditësojë Planin Kombëtar të Transportit (PKT) dhe programet e investimeve, që lidhen me të.

ç) Të ndihmojë ministrinë, që mbulon çështjet e transportit, për rishikimin dhe përditësimin e politikave të sektorit të transportit, rregulloreve dhe të reformave institucionale.

d) Të kryejë punimet dhe shërbimet e tjera studimore, për të tretë, në fushën e transportit, si kryerja e planeve të trafikut urban dhe sinjalistikës në qytete, të trafikut kombëtar, në rrjetin rrugor të vendit e përditësimin e tyre, vlerësime, oponenca, ekspertiza, trajnime etj.

dh) Të marrë pjesë, si konsulent apo partner vendor, me projekte, rajonale dhe të huaja, në fushën e transportit.

3. Kryeministri miraton strukturën dhe organikën e Institutit të Transportit, me propozimin e ministrit që mbulon çështjet e transportit.

4. Ministri, që mbulon çështjet e transportit, miraton rregulloren e organizimit e të funksionimit të Institutit të Transportit.

5. Të ardhurat e krijuara nga Instituti i Transportit, sipas shkronjave “d” e “dh” të pikës 2, të përdoren për të përballuar kostot për këto veprimtari, në përputhje me vendimin nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

6. Drejtori i Institutit të Transportit emërohet nga ministri, që mbulon çështjet e transportit, në mbështetje të vendimit nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

7. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e tjerë rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të jenë sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”.

Për nëpunësit e tjerë të zbatohet lidhja II e vendimit nr.477, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar”.

9. Vendimi nr.568, datë 6.12.1993 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të

Studimeve të Transportit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohet ministria, që mbulon çështjet e transportit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha